

VENDIM
Nr. 667, datë 10.10.2019

PËR SHPËRNDARJEN E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË ZONAVE MALORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 62, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të ndjekë procedurat për shpërndarjen dhe kryerjen e çregjistrimit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe